

**MBI AKTIVITETIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**

**KPP – Buletin periodik 08
Janar 2025**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Në vijim të veprimtarisë së tij gjatë muajit janar 2015 Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit zhvilloi mbledhjet e tij periodike, forumet e dialogut me qytetarët sipas kalendarit të miratuar, takime me organizata të shoqërisë civile, takime të grupeve të punës sipas shtyllave dhe çështjeve etj.

Gjatë kësaj periudhe u përmbyll procesi i hartimit të Dokumentit Analitik (Analizës) për të tri shtyllat, duke reflektuar ndërkohë edhe komentet e shumta të ekspertizës dhe konsulencës ndërkombëtare si dhe vijoi puna për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit për të tri shtyllat: mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit. Gjithashtu u punua për përmbylljen e analizës së sistemit të drejtësisë, me qëllim që pas saj të fillojë konsultimi publik.

Për shtyllën e dytë, antikorrupsioni, ekspertët e nivelit të lartë përfunduan variantin e konsoliduar të analizës, ku reflektuan mbi komentet dhe sugjerimet e dhëna nga grupi i ekspertëve ndërkombëtarë të programit të USAID-it dhe Institutit Demokratik Kombëtar (NDI) lidhur me strukturën e Dokumentit Analitik për antikorrupsionin.

Gjatë muajit janar ekspertët e nivelit të lartë të shtyllës së dytë zhvilluan një sërë mbledhjesh virtuale me 6 ekspertët ndërkombëtarë të USAID-it dhe NDI-së për disa aspekte të shtyllës së antikorrupsionit, me qëllim adresimin më efektiv të gjetjeve të Analizës dhe parashikimin e masave në Planin Kombëtar të Veprimit, duke marrë në konsideratë standartet më të mira ndërkombëtare dhe disa nga praktikatat më të mira europiane të këshilluara për reflektim edhe nga ekspertët ndërkombëtarë.

17 janar 2025

Mbledhet Komisioni i Posaçëm, ekspertët prezantojnë Dokumentin Analitik, caktohen deputetët relatorë

Mbledhja e parë për këtë vit e Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit nisi me prezantimin e Dokumentit Analitik nga grupet e ekspertëve të nivelit të lartë sipas tri shtyllave bazë. Dokumenti Analitik, i cili është i publikuar në faqen e internetit të Komisionit të Posaçëm: www.masl.al, përmban një analizë të plotë të situatës aktuale për tri shtyllave objekt pune të Komisionit të Posaçëm, identifikimin e arritjeve dhe problematikave kryesore në këto fusha si dhe përmbledhjen e gjetjeve dhe rekomandimeve më të rëndësishme, të cilat do të shërbejnë si bazë për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit për secilën shtyllë.

Në prezantimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e parë, MIRËQEVERISJA, prof. dr. Migena Leskoviku bëri një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore sipas 5 komponenteve që përbëjnë shtyllën e mirëqeverisjes: 1) transparencja në administratën publike; 2) integriteti dhe etika në administratën publike; 3) llogaridhënia e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor; 4) ofrimi i shërbimeve të digjitalizuara; 5) efektiviteti dhe transparencja në menaxhimin e financave publike.

Në prezantimin e Dokumentit Analitik për shtyllën e dytë, ANTIKORRUPSIONI, fillimisht prof. asoc. dr. Jonida Rustemaj, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, prezantoi rekomandimet e ekspertëve për komponentët: “Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit politik” dhe “Parandalimi i korrupsionit në administratën publike, sektorët me risk më të lartë ndaj korrupsionit dhe sektorin privat”.

Rekomandimet për komponentin “Funksionimi dhe efienca e institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike” u paraqitën nga z. Ened Topi, përfaqësues i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Shqipëri (ICC Albania). Gjetjet dhe problematikat për komponentin “Parandalimi i financimeve të paligjshme dhe pastrimit të parave” u prezantuan nga prof. asoc. dr. Ledion Shahini, Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës, ndërsa gjetjet për komponentin “Ndërtimi i një shoqërie me integritet” u prezantua nga dr. Ilda Muçmataj, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Në prezantimin e shtyllës së tretë të Dokumentit Analitik, SUNDIMI I LIGJIT, prof. dr. Aurela Anastasi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, bëri një prezantim të gjetjeve dhe rekomandimeve për funksionin ligjvënës. Më tej dr. Emilio Çika, pedagog në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Mesdhetar, paraqiti pjesën që lidhet me funksionin mbikëqyrës, koordinues dhe monitorues të Kuvendit duke respektuar parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve si dhe funksionin zgjedhës. Ph.D.c Mariel Frroku, Fakulteti i Ekonomisë i Universitetit të Tiranës, paraqiti gjetjet për fushën e efektivitetit të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë, për transparencën dhe llogaridhënien e tij, ndërsa prof. asoc. dr. Nadia Rusi, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, paraqiti gjetjet për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut.

Pas prezantimeve Komisioni i Posaçëm caktoi deputetët relatorë për secilën shtyllë, përkatësisht: znj. Milva Ekonomi (shtylla I); znj. Etilda Gjonaj (shtylla II) dhe z. Toni Gogu (shtylla III), në mënyrë që të vijohet me finalizimin e fazës së parë të këtij procesi reformues: shqyrtimi dhe miratimi i Dokumentit Analitik nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar.

Në respektim të procedurave të parashikuara nga Rregullorja e Kuvendit, relatorët me mbështetjen e Sekretariatit Teknik do të përgatitin relacionin përkatës për debatin në Komision dhe miratimin e dokumenteve përkatëse për të tri shtyllat gjatë muajit shkurt.

FORUMET E DIALOGUT ME QYTETARËT, STUDENTËT DHE STAFET AKADEMIKE

Pas përfundimit të 12 tryezave tematike për gjetjet e analizës paraprake, ekspertët e nivelit të lartë të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm gjatë muajit janar vijuan forumet e dialogut me qytetarët. U zhvilluan tri forume në qytetin e Tiranës dhe të Shkodrës, ku morën pjesë studentë dhe pedagogë, përfaqësues

të shoqërisë civile lokale, të institucioneve të pushtetit lokal etj. Në këto forume pjesëmarrësit u informuan mbi analizën e bërë nga ekspertët për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimit të ligjit, për konsultimet me profesionistë të fushës, me grupet e interesit dhe ekspertët ndërkombëtarë. Ekspertët i ftuan pjesëmarrësit të bëhen pjesë e diskutimeve nëpërmjet platformës së Komisionit të Posaçëm www.masl.al.

21 janar 2025

Forumi i dialogut me studentët dhe pedagogët në Universitetin European të Tiranës

Ekspertët dhe deputetët e atashuar pranë Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit zhvilluan një takim me studentët dhe pedagogët në Universitetin European të Tiranës. Gjetjet kryesore të analizës së grupit të ekspertëve për shtyllën II, ANTIKORRUPSIONI, u prezantuan nga prof. asoc. dr. Ledion Shahini, pedagog në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, dhe dr. Sofjana Velu, pedagoge në Universitetin European të Tiranës.

Prof. dr. Ledion Shahini u ndal në gjetjet, problematikat e hasura dhe rekomandimet e ekspertëve për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit politik, parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë ndaj korrupsionit në qeverisjen qendrore dhe vendore, funksionimin dhe eficiencën e institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike, parandalimin e financimeve të paligjshme dhe të pastrimit të parave.

Dr. Sofjana Velu prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e grupit të ekspertëve për ndërtimin e një shoqërie me integritet. Më tej ajo u ndal në analizimin e mekanizmave ekzistues për nxitjen e rasteve të korrupsionit dhe përfshirjen e shoqërisë civile dhe të qytetarëve, në monitorimin e menaxhimit të financave publike dhe të kuadrit ekzistues për ndërgjegjësimin e shoqërisë e veçanërisht të të rinjve.

Më pas dy ekspertët dhe anëtarja e Komisionit të Posaçëm, deputetja Etilda Gjonaj, iu përgjigjën pyetjeve dhe komenteve të studentëve dhe pedagogëve lidhur me masat e propozuara dhe planin e veprimit për të rritur efektivitetin e zbatimit në praktikë të reformave dhe nismave të ndërmarra për të luftuar fenomenin e korrupsionit, rolin e sinjalizuesve dhe nevojën e ndërgjegjësimin të qytetarëve për të denoncuar rastet korruptive, nevojën për futjen në kurrikulat mësimore të informacioneve mbi parandalimin e fenomenit të korrupsionit, nevojën për përçarjen e mesazheve sa më të thjeshta për gjetjet e ekspertëve dhe ndërhyrjet që nevojiten të bëhen në legjislacion, ndryshimin e qasjes për konsultimin publik dhe gjetjen e mekanizmave për të integruar jo vetëm komentet e shoqërisë civile dhe grupeve të interesit gjatë procesit legjislativ, nevojën për rritjen e transparencës në fusha si prokurimet publike, konçensionet (PPP) etj.

24 janar 2025

Forumi i dialogut me studentët dhe pedagogët e Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër

Ndalesa e radhës e ekspertëve dhe deputetëve të atashuar pranë Komisionit të Posaçëm për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit ishte Universiteti “Luigj Gurakuqi” në qytetin e Shkodrës. Studentët dhe pedagogët e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit u njohën nga afër me analizën e bërë nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë e në mënyrë të posaçme me gjetjet e shtyllës së dytë për luftën ndaj korrupsionit dhe parandalimin e tij. Gjetjet u prezantuan nga znj. Ardita Seknaj, përfaqësuese e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Shqipërisë, pjesë e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, e cila bëri një përmbledhje të pesë fushave të analizës dhe të gjetjeve kryesore, që konsistojnë në: mangësi e kapaciteteve dhe koordinimit institucional, kornizë ligjore e fragmentarizuar dhe e paharmonizuar, paqartësi në zbatimin dhe mbikëqyrjen e integritetit publik, mungesë e transparencës dhe llogaridhënies në sektorët me risk më të lartë ndaj korrupsionit në qeverisjen qendrore dhe vendore, masa të paefektshme për pastrimin e parave dhe korrupsionin transnacional, mungesa e ndërgjegjësimit dhe angazhimit të shoqërisë.

Më pas znj. Seknaj dhe deputetja Etilda Gjonaj, anëtare e Komisionit të Posaçëm, iu përgjigjën pyetjeve dhe komenteve të bëra nga studentët dhe pedagogët lidhur me masat e propozuara dhe planin e veprimit për rolin e sinjalizuesve dhe nevojën e ndërgjegjësimit të të rinjve për të denoncuar rastet korruptive, identifikimin e çdo rasti korrupsioni dhe favorit të çdo forme, mekanizmat që do të garantojnë suksesin në procesin e vetingut të institucioneve dhe administratës publike, nevojën e përçarjes së mesazheve sa më të thjeshta për qytetarët dhe gjetjen e mekanizmave për rritjen e besimit për të denoncuar ndikimet apo orientimet e mundshme të politikës në analizën e ekspertëve, si mund të bëhet më llogaridhënëse dhe transparente vendimmarrja e institucioneve etj.

24 janar 2025

Forum i dialogut me qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të pushtetit lokal në qytetin e Shkodrës

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit zhvilloi një takim me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të pushtetit lokal në Shkodër për konsultimin e Dokumentit Analitik, veçanërisht për gjetjet dhe rekomandimet e shtyllës së dytë - ANTIKORRUPSIONI. Znj. Ardita Seknaj paraqiti gjetjet kryesore të analizës si dhe rekomandimet e ekspertëve, duke u fokusuar kryesisht në rolin monitorues dhe kontributin e shoqërisë civile në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, rritjen e besimit të publikut tek institucionet, transparencën në përdorimin e parave publike, etikën dhe integritetin e administratës lokale, nevojën e rritjes së angazhimit të qytetarëve në procesin e auditimit etj. Më pas znj. Senkaj

dhe deputetja Etilda Gjonaj, anëtare e Komisionit të Posaçëm, iu përgjigjën pyetjeve dhe komenteve të bëra nga të pranishmit mbi nevojën e përfshirjes së shoqërisë civile në politikëbërje, rritjen e besimit të shoqëria civile dhe publiku, rritjen e besimit të sinjalizuesit dhe promovimin e kulutrës së denoncimit nga brenda institucioneve publike, rritjen e aksesit në shërbime të personave me aftësi të kufizuara dhe shtresës së marginalizuar të shoqërisë, rishikimin e legjislacionit për shoqëritë tregtare publike, forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile për çështje që lidhen me parandalimin e korrupsionit, masat ndërgjegjësuere për promovimin e integritetit dhe modeleve me integritet në shoqëri, rolin e grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile në monitorimin e menaxhimit të financave publike etj.

27 janar 2025

Planit Kombëtar i Veprimit, ekspertët përfundojnë draftin e parë

Pas informimit në mbledhjen e Komisionit të Posaçëm për metodologjinë e ndjekur dhe propozimet kryesore, ekspertët e nivelit të lartë kanë përfunduar tashmë hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit, që është faza e dytë e këtij procesi gjithëpërfshirës të nisur muaj më parë, kur Kuvendi miratoi rezolutën dhe ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit.

Planit Kombëtar të Veprimit, përpara se të miratohet nga Komisioni i Posaçëm, do t'i nënshtrohet një konsultimi të gjerë gjatë muajit shkurt.

28 janar 2025

Konsolidimi i sistemit të drejtësisë, ekspertët përfundojnë draftin e analizës

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariati Teknik kanë përgatitur draftin e analizës për komponentin “Konsolidimi i sistemit të drejtësisë” të shtyllës së tretë, SUNDIMI I LIGJIT, së bashku me propozimet përkatëse për planin e veprimit në këtë fushë.

Ekspertët kanë bërë një vlerësim të ecurisë së institucioneve të reja të drejtësisë dhe reformës në tërësi, duke e vënë theksin te *pavarësia dhe paanshmëria, përgjegjshmëria e llogaridhënia, cilësia dhe profesionalizmi, eficiencia dhe aksesit, mirëqeverisja, transparenca e sistemit të drejtësisë* etj. Kjo analizë synon të evidentojë progresin e bërë, arritjet dhe dukuritë pozitive, por dhe problematikat që janë konstatuar në zbatimin e reformës në drejtësi në këta 8 vjet nga miratimi i ndryshimeve kushtetuese dhe paketës ligjore të reformës në drejtësi, si dhe të propozojë masat konkrete për konsolidimin e mëtejshëm të reformës në drejtësi.

Kësaj analize do t'i bashkëngjitet edhe një profil institucional për institucionet e reja të drejtësisë (GJK, ILD, KLGJ, GJL, KLP, PP, GJKKO e SPAK, SHM etj.), dokument i cili do të prezantojë progresin, arritjet dhe problematikat në zbatimin e reformës në drejtësi pas ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë.

Rreth drafteve të mësipërme do të ketë gjithashtu një proces konsultimi të gjerë përpara se ato të miratohen nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar dhe të vijohet më tej me Planin Kombëtar të Veprimit.

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit shkurt me agjendën e Komisionit?

Edhe gjatë muajit shkurt 2025 Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit do të vijojë punën për përmbushjen e qëllimeve të tij dhe avancimin me procesin reformues.

Sipas kalendarit të miratuar më parë, do të zhvillohen forumet e dialogut me qytetarët në qytete të tjera, përfshirë takimet me pedagogë e studentë në universitetet publike e jopublike si dhe tryeza bashkëbisedimi me komunitetin e biznesit, me drejtues të qeverisjes vendore dhe përfaqësues të organizatave përkatëse.

Gjatë muajit shkurt Komisioni i Posaçëm Parlamentar do të zhvillojë mbledhjet e tij të zakonshme e periodike, të cilat publikohen në faqen e internetit të Komisionit të Posaçëm: www.masl.al.

Gjatë këtij muaji Komisioni i Posaçëm Parlamentar do të zhvillojë disa mbledhje për të përmbyllur procesin e shqyrtimit dhe miratimit të Dokumentit Analitik për të tria shtyllat.

Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë do të zhvillojë një proces konsultimi të gjerë rreth Planit Kombëtar të Veprimit dhe do ta paraqesë atë për shqyrtim dhe miratim në Komisionin e Posaçëm Parlamentar.

Në të njëjtën kohë do të vijojnë konsultimet me përfaqësuesit e institucioneve të sistemit të drejtësisë, agjencitë e ndryshme ligjzbatuese, profesionistët e fushës (gjyqtarë, prokurorë, avokatë etj.), organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit, komunitetin e biznesit etj. Gjithashtu do të vijojë konsultimi me ekspertë e konsulentë ndërkombëtarë rreth gjetjeve të Dokumentit Analitik për komponentin e tretë, "Konsolidimi i sistemit të drejtësisë dhe profileve institucionale të institucioneve të reja të drejtësisë", përgatitur nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik. Synimi është përmbyllja e këtij procesi konsultimi brenda muajit shkurt 2025.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**